



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	24.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KPMShCK	2979/2023		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.354/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.354/2023 të datës 13.02.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.03.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.354/2023 e datës 13.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi, përmes emailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), me datën 13.02.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.354/2023 me numër protokolli 1698/2023, kundër rezultatit të rivlerësimit të intervistës me gojë të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, lidhur me pozitën Udhëheqës i Divizionit për Bashkëpunim me Nato në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pas nxjerrjes së Vendimit me numër A.nr.1112/2022 të datës 20.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas të cilit lënda e ankuesit është kthyer në fazën e vlerësimit tek Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë lidhur me këtë procedurë të rekrutimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitive Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 23.02.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa, Këshilli me datën 06.03.2023 nga kjo e fundit ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1698/2023 të datës 13.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 06.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 06.03.2023 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së bashku me shkresat e lëndës; Kërkesën/aprovimin e datës 13.07.2022 lidhur me hapjen e konkurseve nga MPJD; Konkursin e datës 20.07.2022 me numër të referencës RN00009443; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Vendimin Nr.Prot.4319 të datës 18.10.2022 lidhur me kriterin për përfshirje në listën e ngushtë; Vendimin Nr.Prot.4320 të datës 18.10.2022 lidhur me kriterin për përfshirje në listën e ngushtë; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar e gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin Nr.Prot.4347 të datës 18.10.2022 lidhur me verifikimin paraprak nga NJBNJ; Vendimin Nr.Prot.4528 të datës 27.10.2022 për themelimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë; Procesverbalin e datës 28.10.2022 lidhur me përpilimin e pyetjeve nga intervista me gojë; Shkresën zyrtare lidhur me mbajtjen e intervistës me gojë; Listën me renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 27.01.2023 e gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin për kandidatin fitues me Nr.Prot.4585 të datës 28.10.2022; Vendimin me numër A.nr.1112/2022 të datës 20.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin-aktin përfundimtar lidhur me përfundimin e procedurës të datës 27.01.2023 si dhe Njoftimin Nr.Prot.1220 të datës 22.03.2023 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPJD lidhur me përfundimin e procedurës pa kandidat fitues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Sipas Konkursit me numër reference RN00009443 për pozitën punës "Udhëheqës i Divizionit për NATO" si kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare, në shkenca të Sigurisë, Juridike ose shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi apo ekuivalente me to.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, gjegjësisht nenit 38 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: "1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni". ...5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm .

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe dispozita e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenin 44 me të cilin është përcaktuar se: "1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje 3.Dispozitat, për procedurën e pranimin në shërbimin civil, të kësaj Rregulloreje, do të zbatohen përshtatshëmrisht edhe për procedurën e konkurimit për lëvizjen brenda kategorisë, për aq sa nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të kësaj rregullore", nenin 47 me të cilin përcaktohet se: "1.KVLBK

zhvilloj një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë”, nenin 48 me të cilin përcaktohet se: “...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbledhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit”, si dhe nenin 49 me të cilin përcaktohet se: “1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues”.

Duke u bazuar në dispozitat si më lartë e në kuptim të vlerësimit të ligjshmërisë së procedurës lidhur me pozitën në fjalë pas ndërmarrjes së veprimeve të Komisionit për Lëvizjen Brenda Kategorisë lidhur me rivlerësimin e kandidatëve, Kolegji ka konstatuar se ankuesi bazuar në rezultatet e vlerësimit të intervistës me gojë sipas listës së datës 28.10.2022 e gjeneruar tek SIMBNJ lidhur me Renditjen përfundimtare të kandidatëve nga ana e anëtarëve të komisionit, del se është vlerësuar me gjithsejtë 45.4 pikë dhe është renditur i dyti, rezultat ky jo i mjaftueshëm për tu emëruar në këtë pozitë. Prandaj për rastin konkret, meqenëse ankuesi nuk ka arritur të grumbulloj pikët e mjaftueshme për emërim të përcaktuara si në dispozitën e nenit 49 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilën decidivisht është përcaktuar që: 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi”, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me atë se i njëjti me rastin e rivlerësimit të intervistës me gojë nga ana e Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë lidhur me pozitën e lartcekur, janë të pa bazuara.


Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.354/2023, datë 24/03/2023

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSSHCK-së.

